

محمد بن عبد الله

40 HADITHE RRETH MIRËSIVE TË DIJES

Tiranë, 2025

Titulli: 40 hadithe rreth mirësive të dijes

**I përktheu nga arabishtja: Haxhi Shejkh
Vullnet MERJA**

I redaktoi: Jerida KULLA

I korrektoi: Ma. Isra MERJA

Përkujdesja kompjuterike: Sabrie FEZA

Kopertina: Sabrie FEZA

Botoi: Shoqata "FLLADI" - Tiranë, 2025

ISLAMI REKOMANDON DIJEN

**Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar. Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër dhe mbi shokët e tij të zgjedhur!

Nuk ka asnjë dyshim që Islami e thekson dhe e rekomandon dijen, në një mënyrë të tillë që nuk e gjejmë te ndonjë

temë tjetër. Në librat më të vjetër islamë të shkruar, gjejmë se nxitja për të kërkuar dijen vjen si një detyrim, ashtu si detyrimet e tjera, si: namazi, agjërimi, Haxhi, xhihadi, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

Përveç ajeteve të ndritshme të Kur'anit, gjejmë se këshilla më e rëndësishme që jep Profeti i nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*), në rrugën e dijes, është një thënie e sigurt për të gjithë myslimanët: “*Kërkimi i dijes është detyrë për çdo mysliman*”.¹ Kërkimi i dijes është detyrë për të gjithë myslimanët

1 “*El Kafi*” i Shejkh Muhamed ibn Jakubit, El Kulejni, redaktuar dhe komentuar nga Ali Ekber El Gifari, vëll. 7, Hadithi 1, f. 30, Teheran, Shtëpia e Librit Islamik, Shtypshkronja “El Hajdari”, 1365 sipas kalendarit iranin, Botimi i dytë.

dhe nuk është i kufizuar vetëm për një shtresë të caktuar apo për një gjini të caktuar. Kushdo që është mysliman, duhet të vazhdojë kërkimin e dijes.

Po ashtu, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij!*) ka thënë: “Kërkojeni dijen, edhe sikur të jetë në Kinë”.² Kjo do të thotë se dija nuk është e kufizuar në ndonjë vend të caktuar. Kudo që gjendet dija, duhet udhëtuar për ta kërkuar.

2 “Ra’edhat el Ua’idhiyn ue Basiretul Mute’izin” i Fatal Nishaburi, Muhamed ibn Ahmed, vëll. 1, f. 11, botuar nga shtëpia botuese “Er Rida”, Iran, Kom, Botimi i parë, 1417 hixhri,.

Cila është dija që ka për qëllim Islami?

Është e nevojshme të shtrojmë një pyetje thelbësore: Kë dije ka për qëllim Islami? Dikush mund të thotë se ajo që synohet, është vetëm dija fetare, domethënë që njerëzit janë të thirrur të mësojnë fenë e tyre. Nëse dija, e përmendur në Islam, nënkupton vetëm dijen fetare, atëherë Islami thjesht ka rekomanduar vetveten dhe nuk ka thënë asgjë për atë që quhet 'dije për realitetet e krijesave dhe njohjen e çështjeve të botës'. Kështu, problemi mbetet siç është, sepse çdo ideologji, pavarësisht sa armiqësore të jetë ndaj dijes dhe njohjes, dhe sado që të

jetë kundër përparimit dhe zhvillimit mendor, nuk mund të kundërshtojë njohjen e vetvetes, përkundrazi, thotë: “Na njihni neve, mos njihni të tjerët!”

Prandaj, nëse ajo që ka për qëllim Islami me “dije”, është vetëm dituria fetare, atëherë orientimi i Islamit ndaj dijes është zero dhe qëndrimi i tij ndaj dijes është negativ.

Megjithatë, ne kemi disa dëshmi të qarta që tregojnë se pikëpamja islame për dijen nuk është e kufizuar vetëm në dijet fetare.

Këndvështrimi i Islamit ndaj dijes

Ai që e njeh Islamin dhe logjikën e tij, nuk mund të thotë se këndvështrimi i Islamit ndaj dijes kufizohet vetëm në dijen fetare. Ky mendim mund të përputhet me mënyrën se si kanë vepruar disa myslimanë në shekujt e mëvonshëm, të cilët e ngushtuan rrethin e dijes dhe e kufizuan atë. Por, fjala e Profetit: *“Dija është pasuria e humbur e besimtarit...”*³, nuk do të kishte asnjë kuptim, nëse me “dije” do të nënkuptohej vetëm feja.

³ Biharul Enuar”, i eruditit El Mexhlisij, vëll. 1, f. 169.

Po ashtu, hadithi tjetër: “Kërkojeni dijen, qoftë edhe në Kinë”⁴, ku përmendja e Kinës është bërë ose sepse ishte vendi më i largët, i njohur në atë kohë, ose sepse njihej si qendër e dijes dhe e industrisë në botë. Por Kina, as në të kaluarën e as në të tashmen, nuk ka qenë ndonjë qendër e dijes fetare.

Duke lënë mënjane të gjitha këto, hadithet e Profetit të nderuar e përcaktojnë dhe e sqarojnë se çfarë nënkuptohet me “dije” në Islam, jo duke përmendur në mënyrë të veçantë se cilat janë ato dije (me emër e mbiemër), por duke i përkufizuar

4 “Uesailu Eshiatu”, vëll. 27, f. 27, Hadithi 20.

ato si: “Dija e dobishme”, ajo dije që sjell dobi, kurse mosnjohja e saj shkakton dëm.

Pra, çdo dije që ka përfitim dhe sjell ndikim pozitiv, sipas Islamit, është e pranueshme dhe konsiderohet e dobishme dhe e vlefshme. Kërkimi i saj është detyrim.

Prandaj, nuk është e vështirë ta kuptojmë çështjen. Ne duhet të shohim çfarë konsideron Islami si dobi dhe çfarë si dëm. Çdo dije që përforcon ndonjë këndvështrim islam individual apo shoqëror dhe mungesa e saj e dëmton këtë këndvështrim, është dije që Islami e rekomandon. Çdo dije që nuk ka ndikim mbi pikëpamjet islame, për atë Islamit nuk

i intereson, veçanërisht. Por çdo dije që ka ndikim negativ, Islami e kundërshton.

Këndvështrimi i Kur'anit fisnik për dijen

Këndvështrimi i Kur'anit, në lidhje me dijen, është një këndvështrim i përgjithshëm, pa ndonjë kufizim apo përjashtim. Kur'ani e përshkruan dijen si dritë, ndërsa injorancën si errësirë. Kur'ani, gjithashtu, paraqet një sërë temash dhe u kërkon njerëzve të reflektojnë mbi to. Këto tema nuk janë tjetër veçse ato që sot i quajmë shkencat natyrore, matematikore, të jetës, historike dhe të tjera si këto.

Për shembull, ajeti thotë: **“Vërtet, në krijimin e qiejve dhe të tokës, në ndërrimin e natës dhe ditës, në anijet që lundrojnë në det për dobinë e njerëzve, në ujin që Allahu e zbriti nga qielli dhe me të e ngjalli tokën pas vdekjes së saj, në përhapjen në të të çdo lloj gjallese, në ndërrimin e erërave dhe retë që janë të nënshtruara mes qiellit dhe tokës, ka padyshim argumente për një popull që mendon”**.⁵ Kjo do të thotë se të gjitha këto dukuri kanë ligje dhe sisteme, dhe njohja e tyre ju afron me njësinë (monoteizmin) e Allahut.

Pra, Kur’ani i urdhëron njerëzit të merren me studimin e këtyre çështjeve,

⁵ Sure “El Bekare, ajeti 164

sepse ato çojnë në studimin e astronomisë, yjeve, tokës, deteve, qenieve ajrore, kafshëve etj. Kjo është e qartë në ajetin e dytë të sures “El Xathije”, në ajetin 25 të sures “El Fatir”, dhe në ajete të tjera.

Zbritja e Kur’anit filloi me fjalën “lexo”. Pra, fillimi i shpalljes hyjnore ishte një drejtim i qartë kah dija dhe arsimi, siç thuhet në ajetet: **“Lexo me emrin e Zotit tënd që krijoi. Krijoi njeriun nga një gjak i ngjizur. Lexo! Se Zoti yt është më bujari, Ai që mësoi me pendë (shkrimin)”**.⁶

Të gjitha këto janë dëshmi që tregojnë se këndvështrimi i Islamit ndaj

6 Sure “El Alak”, ajetet 1-4.

dijes nuk është i kufizuar vetëm në dijet fetare.

Që në kohët e lashta është zhvilluar një debat i gjatë rreth asaj se cilën dije ka për qëllim Islami, që e konsideron të domosdoshme dhe detyrim për t'u përvetësuar. Çdo grup përpiquej ta paraqiste këtë koncept mbi atë degë të dijes që përfaqësonte vetë.

Teologët thoshin: “Qëllimi është teologjia (ilmul kalam)”.

Komentuesit e Kuranit thoshin: “Qëllimi është dituria e komentimit të Kur'anit (tefsiri)”.

Studiuesit e hadithit thoshin: “Është shkenca e hadithit”.

Fukahatë (juristët islamë) thoshin: “Është fik’hu (jurisprudenca islame) dhe çdo njeri duhet të jetë ose jurist, ose ndjekës i një juristi”.

Moralistët thoshin: “Është etika, njohja e gjërave që të shpëtojnë dhe gjërave që të shkatërrojnë”.

Sufistët thoshin: “Është dija e udhëtimit shpirtëror (sejri e suluki) dhe e teuhidit praktik”.

Imam Gazaliu përmend njëzet mendime të ndryshme për këtë çështje.

Por studiuesit që janë thelluar në këto dije, thonë se qëllimi nuk është asnjë nga këto dije, në mënyrë të veçantë, sepse, nëse do të kishte qenë ndonjë dije e caktuar ajo që kërkohej, atëherë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) do ta kishte përmendur dhe do ta kishte përcaktuar atë me emër.

Por qëllimi është: çdo dije që është e dobishme dhe sjell dobi për njerëzit.

Për t'u njohur më shumë me mirësitë e dijes dhe me pozitën e lartë të saj në Islam, Fondacion i Kur'anit, në bashkëpunim me shoqatën "Flladi" kanë përgatitur libërthin me titull **"40 hadithe rreth mirësive të dijes"**.

Me këtë rast, Fondacioni i Kur'anit falënderon të gjithë bashkëpunëtorët që ndihmuan në përgatitjen e këtij libërthi, i vogël në volum, por i madh nga përmbajtja e tij. Allahu u dhëntë suksese e mirësi dhe i shpërbleftë me Xhenet në Jetën Tjetër!

Allahu na e ndriçoftë këtë jetë me dritën e dijes!

Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

40 HADITHE
RRETH
MIRËSIVE TË DIJES

Hadithi 1

Mësimi – qëllimi i dërgimit të Profetit Muhamed (a.s)

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: “Unë jam dërguar për të mësuar (për t’i mësuar njerëzit)”.⁷

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): "بِالتَّعْلِيمِ أُرْسِلْتُ"

⁷ “Biharul Enuar”, vëll. 1, f. 20.

Hadithi 2

Nderimi i dijetarit është nderim ndaj Zotit

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"Kush e nderon një dijetar, padyshim ka
nderuar Zotin e tij".⁸

قال الامام علي (عليه السلام): "مَنْ وَفَّرَ عَالِمًا فَقَدْ وَفَّرَ رَبَّهُ"

⁸ "Mu'xhemul elfadhil Gurarul Hikem", f. 1207.

Hadithi 3

Kush është më i vlefshmi i njerëzve?

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë:
“Më i vlefshmi i njerëzve është ai që ka më shumë dije”.⁹

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): "أَكْثَرُ النَّاسِ قِيَمَةٌ أَكْثَرُهُمْ عِلْمًا"

⁹ "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 164.

Hadithi 4

Mëso, sa je i ri!

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
"Kush mëson në rininë e tij, (dija e tij) është si gdhendja në gur, (e qëndrueshme dhe e pashlyeshme)".¹⁰

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): مَنْ تَعَلَّمَ فِي شَبَابِهِ كَانَ يَمْزِلُهُ الرَّسْمُ فِي الْحَجَرِ

¹⁰ "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 222.

Hadithi 5

Udhëto për dije!

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Kërkojeni dijen, edhe sikur ajo të jetë në Kinë”.¹¹

«أَطْلُبُوا الْعِلْمَ وَلَوْ بِالصِّينِ»

¹¹ “Biharul Enuar”, vëll. 1, f. 180.

Hadithi 6

Etika e mësimdhënies dhe mësimnxënies

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Jini të butë si me nxënësin që e mësoni, ashtu edhe me mësuesin prej të cilit mësoni”.¹²

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): "لينوا لمن تعلمون ولمن تتعلمون منه."

¹² "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 62.

Hadithi 7

Ji i përrulur, ji i përrulur!

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Tregohuni të përrulur si ndaj atij që ia
mësoni diturinë, ashtu edhe ndaj atij prej të
cilit kërkoni dituri”.¹³

قال الامام الصادق (عليه السلام): "تواضعوا لمن تعلمونه العلم وتواضعوا لمن طلبتم منه العلم"

¹³ "El Kafi", vëll. 1, f. 36.

Hadithi 8

Mos i thua j këto!

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Mos thua j atë që nuk e di, madje mos thua j as gjithçka që e di”.¹⁴

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "لا تقل ما لا تعلم بل لا تقل كل ما تعلم."

¹⁴ “Nehxhul Belaga”, Urtësia 374.

Hadithi 9

Shenjat e dijetarit

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “O kërkues i dijes! Dijetari ka tri shenja: diturinë, durimin dhe heshtjen”.¹⁵

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "يا طالب العلم! ان للعالم ثلاث علامات:
العلم والحلم والصمت."

¹⁵ "El Kafi", vëll. 1, f. 37.

Hadithi 10

Kush është dijetari i vërtetë?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Nuk është dijetar ai që veprat e tij nuk
vërtetojnë fjalën e tij”.¹⁶

قال الامام الصادق (عليه السلام): "من لم يصدق فعله قوله فليس بعالم."

¹⁶ "El Kafi", vëll. 1, f. 36.

Hadithi 11

Drejtoji sytë nga këta!

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Të shikosh fytyrën e dijetarit është adhurim”.¹⁷

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): "النظر الى وجه العالم عبادة."

¹⁷ "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 195.

Hadithi 12

Me kë duhet të shoqërohemi?

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Të qëndrosh në shoqëri të dijetarëve është adhurim”.¹⁸

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): "مجالسة العلماء عبادة."

¹⁸ "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 204

Hadithi 13

Llojet e dijes

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Dijet janë katër llojesh: Fik’hu për njohjen e feve, mjekësia për shëndetin e trupit, gramatika për të folurin, astronomia për të njohur kohët”.¹⁹

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "العلوم اربعة: الفقه للاديان والطب للابدان والنحو للسان والنجوم لمعرفة الارمان."

¹⁹ "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 204.

Hadithi 14

Për të mësuar, edhe lajkat janë të lejuara

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Lajkat nuk janë nga sjelljet e besimtarit, përveçse në kërkimin e dijës".²⁰

قال رسول الله (صل الله عليه وآله): "ليس من اخلاق المؤمن الملق الا في طلب العلم."

²⁰ "Biharul Enuar", vëll. 2, f. 45.

Hadithi 15

Ky është çelësi i dijes

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Dija është e mbyllur me një dry dhe çelësi
i saj është pyetja”.²¹

قال الامام الصادق (عليه السلام): "ان هذا العلم عليه قفل ومفتاحه المسألة."

²¹ "El Kafi", vëll. 1, f. 40.

Hadithi 16

Mos e harro shënimin e dijes!

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Lidheni (ruajeni) dijen me shkrimin”.²²

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): "قيّدوا العلم بالكتاب."

²² "Biharul Enuar", vëll. 77, f. 141.

Hadithi 17

Të kesh një bibliotekë është gjë e mirë

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Ruajini librat tuaj, sepse në të ardhmen do
të keni nevojë për ta”.²³

قال الامام الصادق (عليه السلام): "احتفظوا بكتبكم فانكم سوف تحتاجون اليها."

²³ "El Kafi", vëll. 1, f. 52.

Hadithi 18

Merrni më të mirën nga dija!

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Dija është më shumë se sa mund të numërohet, prandaj merr më të mirën nga çdo gjë”.²⁴

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): "العلم أكثر من أن يحصى فخذ من كل شيء أحسنه."

²⁴ "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 219.

Hadithi 19

Nëse mundesh, mëso gjuhën arabe!

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Mësojeni gjuhën arabe, sepse është gjuha
me të cilën Allahu u flet krijesave të Tij”.²⁵

قال الامام الصادق (عليه السلام): "تعلموا العربية فانها كلام الله الذي يكلم به خلقه."

²⁵ "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 212.

Hadithi 20

Mos e zgjat shumë mësimdhënien!

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë se Hazreti Hidri (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha Profetit Musa (*Paqja qoftë mbi të!*): “O kërkues i dijes! Folësi lodhet më pak se dëgjuesi, prandaj mos i lodh shokët e tu, kur u flet”.²⁶

²⁶ “Biharul Enuar”, vëll. 1, f. 226.

Hadithi 21

Mësojuni fëmijëve tuaj këtë gjë!

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Mësojuni fëmijëve tuaj ato gjëra që u sjellin dobi nga Allahu, që të mos mbizotërohen nga mendimet e devijuara të sektit Murxhia”.²⁷

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "علموا صبيانكم ما ينفعهم الله به لا يغلب عليهم المرجئة برايا."

²⁷ "Biharul Enuar", vëll. 2, f. 17.

Hadithi 22

A e dini prej kujt po e merrni dijen tuaj?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Shikoni mirë prej kujt po e merrni dijen
tuaj”.²⁸

قال الامام الصادق (عليه السلام): "فانظروا علمكم هذا من تآخذونه"

²⁸ "El Kafi", vëll. 1, f. 32.

Hadithi 23

Vlera e iranianëve në kërkimin e dijes

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: "Edhe nëse për të mësuar dijen duhet të shkohet deri te ylli Thureja, njerëz nga Persia (Irani) do ta arrijnë atë".²⁹

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): "لو كان العلم منوطا بالثريا لتناوله رجال من فارس."

²⁹ "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 195.

Hadithi 24

Shoqëroje dijen me thellim mendimi

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Sigurisht, nuk ka dobi në dijen që nuk thellohesh”.³⁰

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "الا لا خير في علم ليس فيه تفهم."

³⁰ "El Kafi", vëll. 1, f. 36.

Hadithi 25

Çohu në këmbë, në shenjë respekti, për mësuesin!

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Ngrihu nga vendi yt për babanë dhe mësuesin tënd, edhe nëse je një prijës”.³¹

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "ثم عن مجلسك لابيک ومعلمک ولو کنت امیرا"

³¹ "Mustedrekul Uesiali", vëll. 15, f. 203.

Hadithi 26

Ji shërbyes i dijetarit!

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Kur të shohësh një dijetar, bëhu shërbyesi i tij”.³²

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "اذا رايت عالما فكن له خادما."

³² "Mu'xhemul elfadhil Gurarul Hikem", f. 286.

Hadithi 27

Biseda shkencore është më e mirë se një natë faljeje

Imami Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Një orë kujtese dhe bisede mbi diturinë
është më e vlefshme se një natë e tërë
adhurimi”.³³

قال الامام الباقر (عليه السلام): "تذكر العلم ساعة خير من قيام ليلة."

³³ "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 204.

Hadithi 28

Mos ki turp të jesh nxënës!

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Askush të mos turpërohet të mësojë një gjë që nuk e di”.³⁴

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "لا يستحين احد اذا لم يعلم الشي ء ان يتعلمه."

³⁴ “Nehxhul Belaga”, Urtësia 79.

Hadithi 29

Ku është maja e dijes e ku rehatia e trupit!

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Dija nuk arrihet me rehati të trupit”.³⁵

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "لا يدرك العلم براحة الجسم."

³⁵ “Mu'xhemul elfadhil Gurarul Hikem”, f. 150.

Hadithi 30

Kurrë mos u dëshpëro!

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Dijetar është ai që nuk lodhet nga të mësuarit”.³⁶

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "العالم الذی لا یمل من تعلم العلم."

³⁶ “Mu'xhemul elfadhil Gurarul Hikem”, f. 1063.

Hadithi 31

Mos i bëj presion nxënësit, edhe nëse je mësues!

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Më i urryer ndër robtë tek Allahu i Lartësuar, është dijetari mendjemadh”.³⁷

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "ابغض العباد الى الله سبحانه العالم المتجبر"

³⁷ "Mu'xhemul elfadhil Gurarul Hikem", f. 141.

Hadithi 32

Nëse nuk di, thuaj nuk di!

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Të thuash ‘nuk e di’ është gjysma e dijes”.³⁸

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): قول «لا اعلم» نصف العلم

³⁸ “Mu'xhemul elfadhil Gurarul Hikem”, f. 1105

Hadithi 33

Mos u krekos me dijen tënde!

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Për të qenë injorant mjafton të krenohesh me dijen tënde”.³⁹

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "حسبك من الجهل ان تعجب بعلمك."

³⁹ "Biharul Enuar", vëll. 2, f. 48.

Hadithi 34

Mjerë nga zilia dhe përçmimi!

Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
“Njeriu nuk bëhesh dijetar, përveçse kur
nuk ndien zili ndaj atij që është mbi ty dhe
nuk përçmon atë që është poshtë teje”.⁴⁰

قال الامام باقر عليه السلام: "لا يكون العبد عالما حتى لا يكون حاسدا لمن فوقه ولا محقرا
لمن دونه."

⁴⁰ "Biharul Enuar", vëll. 78, f. 173.

Hadithi 35

Unë jam ai që...

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
"Kush thotë: 'Unë jam i ditur', është injorant".⁴¹

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): "من قال: انا عالم فهو جاهل."

⁴¹ "Biharul Enuar", vëll. 2, f. 110.

Hadithi 36

Mëso përvojë shkencore, edhe nga të tjerët!

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Më i dituri i njerëzve është ai që bashkon diturinë e të tjerëve me dijen e vet”.⁴²

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): "اعلم الناس من جمع علم الناس الى علمه."

⁴² "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 164.

Hadithi 37

Dija më e mirë dhe më e keqe

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Dija më e mirë është ajo që e ndreq udhëzimin tënd, kurse dija më e keqe është ajo që e prish Ahiretin (Botën Tjetër) tënd”.⁴³

قال امير المؤمنين الامام على (عليه السلام): "خير العلم ما اصلحت به رشادك وشره ما افسدت به معادك."

⁴³ "Mu'xhemul elfadhil Gurarul Hikem", f. 421.

Hadithi 38

Kurrë mos ndihmo të padrejtët!

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë:
"I mallkuar, i mallkuar qoftë ai dijetar që i
prin një sundimtari tiran dhe e ndihmon në
padrejtësinë e tij".⁴⁴

قال الامام باقر عليه السلام: "ملعون ملعون عالم يؤم سلطانا جائرا معينا له على جوره."

⁴⁴ "Biharul Enuar", vëll. 75, f. 381.

Hadithi 39

Pse e kemi harruar shkrimin?

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Kur besimtari vdes dhe lë pas një letër, mbi të cilën ka shkruar dije, ajo letër në Ditën e Kiametit do të jetë mburojë mes tij dhe zjarrit të Xhehenemit”.⁴⁵

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): "المؤمن اذا مات وترك ورقة واحدة عليها علم تكون تلك الورقة يوم القيامة سترا فيما بينه وبين النار."

⁴⁵ "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 198.

Hadithi 40

*Fundi i lavdishëm i mësimdhënies dhe
mësimnxënies është të bëhesh dëshmor*

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut
qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë:
“Kur vjen vdekja te një kërkues i dijes,
ndërkohë që ai është në këtë gjendje (duke
kërkuar dije), ai vdes si dëshmor”.⁴⁶

قال رسول الله (صل الله عليه و آله): "إذا جاء الموت طالب العلم وهو على هذه الحال
مات شهيدا."

⁴⁶ "Biharul Enuar", vëll. 1, f. 186..

اسم الكتاب: اربعون حديثاً عن العلم و التعلم

المترجم: الشيخ ولنت (عباس) مزيّا

التصحيح الأدبي: يريدا كول

التصحيح اللغوي: إسراء مزيّا

الإخراج النهائي: صبريه فزا

الغالف: صبريه فزا

الناشر: موسسه قرآن، تيرانا- البانيا - 2025